



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 342/2 Prot

Tiranë më 28.04. 2015

V E N D I M

Nr 44, datë 28/04 /2015

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 3, datë 27.01.2015 "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar kryesisht, procesin e mbikëqyrjes tematike, për administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Objekti i mbikëqyrjes është kufizuar në disa institute të ligjit, ndër të cilat deklarimi i statusit të punësimit për punonjësit e institucionit që kanë qenë në marrëdhënie pune në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si detyrim i parashikuar në mënyrë të shprehur në dispozitat tranzitore të ligjit; respektimi i kërkesave të përgjithëshme për pranimin në shërbimin civil; përshkrimi i punës për pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas formës dhe procedurës së kërkuar nga ligji, si dhe për çdo problem tjetër me të evidentuar nga njësia përgjegjëse gjatë zbatimit në praktikë të ligjit.

Mbikëqyrja është zhvilluar në përputhje me programin nr. 136/2 prot., datë 27.01.2015 "*Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil*", i cili i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 136/1 prot., datë 27.01.2015 "*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin, dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr.136/3, datë 10.03.2015 "*Dërgohet projektraporti*", duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me materialin.

Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, me shkresën e regjistruar pranë Komisionerit, me nr. 136/4, datë 24.03.2015 "*Dërgohen komente për projektraportin*".

Nga përmbajtja e komenteve, rezulton se subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakort me konkluzionet e arritura nga grupi i punës, nuk ka pasur vërejtje në lidhje me materialin dhe ka informuar Komisionerin, se ka filluar nga puna për të zbatuar rekomandimet në lidhje me parregullsitë e konstatuara.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vijoi me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të kryer në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse të revokojë aktin e konfirmimit për punonjësen ***** , në pozicionin "*Specialiste*", në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe të vijoje procesin me nxjerrjen e vendimit të deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 3 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar).
3. Njësia përgjegjëse të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësen ***** , në pozicionin e punës "*Inspektor*", në Drejtorinë e Hetimit dhe Inspektimit, duke i shtuar faktin që punonjësja duhet të konsiderohet në periudhë prove, për periudhën e mbetur prej 4 muaj.

Njësia përgjegjëse të zbatojë të gjitha kërkesat që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë krijimin e kushteve për përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP) dhe përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t'u kujdesur për ecurinë e tij.

4. Njësia përgjegjëse të fillojë menjëherë procesin e hartimit të përshkrimeve të reja të punës, në përputhje me kërkesat dhe standartet ligjore të përcaktuara në ligjin nr.

152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) dhe akteve nenligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

5. Të përfundojë verifikimi i gjendjes gjyqësore për nëpunësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe të materializohet procesi në dosjen e personelit.
6. Të plotësohet dosja e personelit, në rastet e konstatuara me mungesa, sipas aneksraportit që është pjesë e këtij vendimi.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
8. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me masat e mara për zbatimin e këtij vendimi.
9. Për këtë vendim të njoftohet Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA